

FJALA E DEPUTETES ZHENI GJERGJI

E MËRKURË 9 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Projektbuxheti i vitit 2023, që po diskutojmë sot në këtë seancë, paraqet një interes të veçantë për qytetarët, ndaj përgjegjësia jonë si përfaqësuesit e tyre është vlerësimi me sinqeritet, nga të gjitha palët e përfshira në diskutime, i dimensionit të këtij buxheti, në të mirë të popullsisë shqiptare dhe zhvillimit të mëtejshëm të vendit.

Sot, qeveria, përmes gjuhës dhe shifrave, do t'u paraqesë shqiptarëve buxhetin e vitit 2023, që, në këndvështrimin e gjitha diskutimeve të opozitës dhe në të gjitha komisionet përkatëse, vlerësohet përsëri se ka një qasje të dukshme në funksion të politikës elektorale, aq më tepër që viti që vjen do të jetë vit zgjedhor.

Sipas të gjitha vlerësimeve të ekspertëve të fushave të ndryshme, qeveria "Rama" edhe me këtë buxhet vazhdon të rrisë shpenzimet publike, borxhet dhe varfërinë e shqiptarëve.

Diskutimet për buxhetin, por edhe për rishikimet e buxhetit, marrin një rëndësi të veçantë për ne, pasi Shqipëria, vendi ynë, prej shumë vitesh po përballet me një qeveri koncesionesh; vendi ynë është kampion për sa i përket korrupsionit dhe, sipas të gjitha klasifikimeve dhe sipas rekomandimeve të Fondit Monetar të Ndërkombëtar, është ndër vendet me nivele të larta të korrupsionit, ku 30% e kapitaleve zhduken.

Nëse të lind kurioziteti për të analizuar se ku ndryshon politika fiskale dhe buxhetore për vitin 2023, vëren strukturën e njëjtë të trajtimit të fushave ku synon buxheti, për më tepër tekstin pothuajse të njëjtë si për vitin 2022, edhe për vitin 2023, dhe arrin të kuptosh se politikat nuk kanë asnjë qasje të re. Sigurisht, nëse i ke parë me kujdes relacionet e ministrive përkatëse gjatë këtyre ditëve, në ngutje e sipër, me vonesa e paqartësi në komunikime, vë re se materialet janë kopjuar dhe përsëritur, copy paste me të dhënat e reja, për të mos u lodhur asnjë prej ekspertëve dhe organizatat që monitorojnë

prezantimet e buxhetit në vendin tonë. Kur shikon përsëritjen e të njëjtit fjalor dhe të së njëjtës frymë arrin të perceptosh se nuk është reflektuar për atë që është kërkuar prej ekspertëve dhe opozitës përgjatë një viti, me argumente me shkrim, me takime, me analiza dhe studime për një buxhet për ekonominë, për qytetarin dhe për të ardhmen e vendit.

Të nderuar qytetarë,

Duke lexuar me vëmendje projektbuxhetin e vitit 2023, në veçanti projektbuxhetin për shëndetësinë, kujtoj diskutimet tuajat e tonat të një viti më parë, kur paraqitej projektbuxheti i vitit 2022 nga qeveria, për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, si një buxhet historik, i cili përbënte 4,89% të PBB-së. Natyrshëm, nëpërmjet të gjitha diskutimeve tona dhe kushteve në të cilat ndodhej shëndeti i popullatës nga Covid-19, ne të gjithë ju përgëzuan për rritjen e buxhetit, edhe pse ishim të bindur që këto para nuk do të shkonin te popullata, por do të shërbenin për pagesat fiktive të koncesioneve, të oligarkëve, të check-up-it, të dializës, të sterilizimit të mjeteve kirurgjikale, të koncesionit korruptiv të laboratorëve në spitalet rajonale, abuzime këto që Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka denoncuar në raportet e tij vit pas viti.

Ndërkohë, në projektligjin “Për buxhetin e vitit 2023”, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vlera totale e shpenzimeve buxhetore është 3,59% e PBB-së, ku vetëm shëndetësia është 66 miliardë lekë. Kjo vlerë është dukshëm nën masën 5% të premtimeve të fushatave elektorale të qeverisë, një premtim politik ky plotësisht i pambajtur.

Duke shfletuar projektbuxhetin e vitit 2023 dhe duke parë prioritet në shëndetësi (2023-2025), vura re që ato nuk kanë ndryshuar nga një vit më parë, as pika e presja nuk ndryshojnë në hartimin e tyre, edhe pse situata shëndetësore e popullatës përgjatë këtij viti ka ndryshuar nga përballja me pasojat afatgjata të Covid-19, gjë për të cilën nuk ka asnjë reflektim nga Ministria e Shëndetësisë gjatë viti 2022 e asnjë plan apo zë të detajuar të shpenzimeve për vitin 2023.

Nuk gjejmë informacion për fondin e planifikuar të vaksinave booster.

Nuk gjejmë informacion për paketën e ilaçeve të rimbursimit. A do të vijojë të rimburohet paketa kundër Covid-19? Cilat barna planifikohen të shtohen në listën e rimbursimit? A adresojnë ato nevojat reale të kategorive të ndryshme të sëmundjeve?

Ajo që të bie më shumë në sy teksa shikon buxhetin për shëndetësinë është fakti që shqiptarët do të paguajnë sërish për oligarkët e qeverisë “Rama”.

Check-up-i në vitin 2023 do të marrë 876 milionë lekë.

Për instrumentet kirurgjikale janë 1,75 miliardë lekë ose 50 milionë lekë më shumë se një vit më parë.

Edhe për sa i përket numrit të pacientëve përfitues nga shërbimi i hemodializës asgjë nuk ka ndryshuar, edhe pse karakteristikat e popullatës kanë ndryshuar shumë. Për shërbimin e dializës, pavarësisht rëndësisë dhe impaktit në popullatën specifike, janë 875 milionë lekë ose 40 milionë lekë më shumë se në vitin 2022, edhe pse karakteristikat e popullatës kanë ndryshuar.

Për shërbimet laboratorike janë 1,7 miliardë. Ky zë pëson një rritje me 125,1 milionë lekë ose 1,1 milionë euro krahasuar me një vit më parë.

Pra, në total, PPP-të për vitin 2023 do t'u kushtojnë xhepave të shqiptarëve plot 481,3 milionë lekë ose, e thënë ndryshe, 4,15 milionë euro më shumë se një vit më parë.

Recetat e rimbursueshme janë një problem madhor i shëndetësisë dhe i popullatës. Është i njëjti numër recetash të rimbursueshme. Pra, edhe në vitin 2023 do të përfitojnë nga fondi 400 mijë pacientë në vit. Natyrshëm, pa studime të mirëfillta për sëmundshmëritë kronike në vend, ne vazhdojmë vit pas viti me të njëjtin numër pacientësh që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë, transplantit renal, kataraktës, ndërkohë që ngjarjet kardiovaskulare dhe cerebrale referohen në rritje gjatë vitit 2022, edhe në afatgjatë, në vitin 2023, si pasojë e Covid-19.

Në vijim, te produkti "Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim nga mjeku i familjes" vihet re një dyfishim i kostove, ndërkohë që numri i pacientëve të trajtuar do të mbetet i njëjtë edhe për vitin 2023. Pra, lista e medikamenteve të rimbursueshme do të vazhdojë të jetë me kufizime për pacientët me komplikacione të rënda të sëmundjeve kronike, si diabetikët, pacientët me degjenerime makulare, si dhe pacientët me sëmundje autoimune, të cilët i marrin medikamentet falas vetëm për 1-3 vjet e, më pas, sikur të jenë shëruar, përjashtohen nga skema për t'i blerë në treg medikamentet me çmime krejt të papërbalueshme, si, për shembull, Lucentis (Eylea) dhe Tofacitinib. Edhe këtu mendohet për grosistët e farmaceutikës, që jo pak herë janë të lidhur me pushtetin e tenderat korruptivë në shëndetësi.

Miratimi nga ana juaj i ligjit "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" në legjislaturën e kaluar, nuk ka asnjë projeksion në projektbuxhetin e 2023, ku shërbimi spitalor do të njohë vetëm ulje të kostos së trajtimit për pacientët e shtruar në spitale, pra ulje të cilësisë së shërbimit.

Fatkeqësisht, ky është realiteti i buxhetit për shëndetësinë, që përsëri mbetet i ulët krahasuar jo vetëm me vendet europiane, por edhe me vendet e rajonit.

Shërbimi i Kërkimit dhe Analizës në Kuvend na ka sjellë një grafik, ku referohet se Shqipëria renditet e katërta në rajon, pas Serbisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut, që kanë shifra më të larta të buxhetit për shëndetësinë. Ky realitet ka mbi 2 vjet që po ju demaskon para qytetarëve, të cilët tashmë e dinë mirë se sa duhet të paguajnë për shëndetin e tyre.

Për sa i përket mbështetjes sociale të popullatës, buxheti i vitit 2023 do të pësojë një reduktim të buxhetimit prej 1,1 miliardë lekësh ose gati 10 milionë euro më pak në vitin 2023, krahasuar me vitin 2022.

Lidhur me ndihmën ekonomike, reduktohet numri i familjeve përfituese, nga 67 mijë familje në 64 mijë familje, pra 3 mijë familje më pak; po ashtu, vlera e fondit reduktohet me mbi 400 milionë lekë. Ndërkohë, referuar raportit të UNICEF-it, efekti i rritjes së çmimeve ka krijuar mbi 40 mijë familje në varfëri ekstreme në Shqipëri deri në shtator të vitit 2022. Cili kriter i ka përjashtuar nga skema e ndihmës ekonomike këto 3 mijë familje?

Për vitin 2022, sipas UNICEF-it, 12 mijë fëmijë më shumë kanë hyrë nën minimumin jetik të varfërisë, për shkak të mungesës së politikave të duhura sociale dhe ekonomike, të cilat mund të zbusnin efektet e krizës së krijuar nga rritja e çmimeve.

Këto janë shifra që flasin vetë dhe jo ato që referoni ju.

Për ta thënë thjesht, projektbuxheti i vitit 2023 tregon dhe një herë se për ju, ministra e kolegë deputetë të maxhorancës, interesi i qytetarit është pak i dukshëm, ndërsa interesi i qeverisë “Rama 3” për oligarkët e PPP-të vazhdon të rritet.

Faleminderit!